

1. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2016

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹). Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore
31-Mar-16		8,540.00
7-Apr-16		9,140.00
14-Apr-16		15,150.00
21-Apr-16		13,800.00
22-Apr-16	8,410.00	
28-Apr-16		14,090.00
5-May-16		14,700.00
12-May-16		15,900.00
19-May-16		21,222.00
20-May-16	5,960.00	
23-May-16	12,390.00	
26-May-16		19,385.00
2-Jun-16		21,860.00
9-Jun-16		21,080.00
16-Jun-16		29,110.00
23-Jun-16		23,600.00

1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016 përbëhen nga operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit, si dhe nga operacione rregulluese me synim menaxhimin e tepricave të likuiditetit në fund të periudhës.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar rezultoi mesatarisht 18² miliardë lekë kundrejt 10.2 miliardë lekëve në tremujorin e mëparshëm. Nevoja për likuiditet ka ardhur në rritje, duke u stabilizuar në nivelet më të larta në dy muajt e fundit të periudhës në rreth 23 miliardë lekë.

Në operacionet e tregut të hapur, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për injektimin e mesatarisht 17.45 miliardë lekëve, kundrejt

7.5 miliardë lekëve në tremujorin e mëparshëm. Gjatë këtij tremujori, nuk është kryer asnjë ankand për injektim njëmuajor apo tremujor kundrejt mesatarisht 10.8 miliardë lekëve injektim njëmuajor në periudhën e mëparshme, Operacioni injektues njëditor është përdorur në 3 raste në fund të periudhës së RD-së për mesatarisht 8.7 miliardë lekë për të plotësuar mungesën e likuiditetit në sistem.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Bankat kanë përdorur depozitën njëditore në 1 rast me normë 0.25% kundrejt 0% në tremujorin e mëparshëm për shumën 0.4 miliardë lekë. Ndërkaq, kredia njëditore është përdorur në 3 raste për mesatarisht 5 miliardë lekë, kundrejt 3.3 miliardë lekëve periudhën e mëparshme.


¹ Shifrat janë në vlerë nominale.

² Shifrat janë me çmim blerjeje.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën dhjetor 2009-qershor 2016.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2009-2016 (me vlerë nominale)
Burimi: Banka e Shqipërisë




2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2016

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e dytë të vitit 2016 Burimi: Banka e Shqipërisë



2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e dytë të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj, nëpërmjet investimit pranë BSH-së të tepricave në valutë. Në fund të tremujorit të parë, marrëveshjet e pamaturuara *swap* qenë 345 milionë euro dhe 50 milionë SDR, por ato ranë gjatë tremujorit nën vëzhgim në 250 milionë euro. Me kërkesën e MF-së, BSH-ja ka blerë 45 milionë SDR dhe kundravlehtë në lekë e kësaj marrëveshjeje qe 7.6 miliardë lekë. Si rezultat i marrëveshjeve *swap* dhe blerjes së 45 milionë SDR, blerjet e Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 123,769.20 milionë lekë dhe shitjet qenë 116,333.06 milionë lekë .

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 40.00 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD). Blerjet dhe shitjet e valutës nga ASD-ja qenë 13.84 milionë lekë.

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera
Burimi: Banka e Shqipërisë

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	123,769.20	116,333.06
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE	13.84	13.84
TË TJERA (IBRD)	70.00	